



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:032249

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497161

P.nr.197/15

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me sekretaren juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit L.N nga fsh....-Kaçanik, për shkak të veprës penale në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-se, dhe veprës penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së, sipas Aktakuzes të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.752-2/14 të datës 21.04.2015, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 25.03.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.752-1/14 e datës 21.04.2015, ndaj të pandehurit L.(E...) N. nga fsh....-Kaçanik, I lindur me dt...., me nr.personal:..., për shkak të veprës penale, në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-se, dhe veprës penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

Të dëmtuarit: A. V., V. B. dhe B. B. nga fsh....-Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.752-2/14 të datës 21.04.2015, kundër të pandehurit L.N nga fsh....-Kaçanik, për shkak të veprës penale në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-se, dhe veprës penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së

Gjykata konstatoi se vepra penale në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, dhe vepra penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së, janë kryer mes datës 01-02. Mars 2014.

Sipas nenit 106 par.1 të KPK-së, 04/L-082, për veprën penale në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 5 vite, ndërsa për veprën penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së, është paraparë afati I parashkrimit prej 3 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstaton se për veprën penale në vazhdim, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, me datë 02.03.2024 ka arritur afati i parashkrimit, ndërsa për veprën penale, Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK-së, me dt.02.03.2020 ka arritur afati I parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se gjashtë respektivisht dhjetë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve në contest civil u mor konfor nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.197/15 datë 25.03.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.